



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr. 149/2014**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Muhamet Rexha dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Prizren, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, dega në Prizren, për shkak të vendosjes së posterëve në ndërtesë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 06.06.2014, mori këtë:

**VENDIM**

**Miratohet** si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), ndërsa Partisë Demokratike të Kosovës, dega në Prizren i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 1300 (njëmijë e treqindë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

**Arsyetim**

Me datën 04.06.2014, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Lëvizja Vetëvendosje dega në Prizren, në të cilën pretendohet se me datën 03.06.2014 aktivistët e Lëvizjes Vetëvendosje konkretisht aktivistja Marigone Drevinja rreth orës 12:15 ka vërejtur se në rrugën Jeronim De Rada në Prizren në objektin që është në pronësi publike ishte vendosur poster i kandidatit Irfan Fusha nga Partia Demokratike e Kosovës. Parashtruesi i ankesës thekson se me këtë veprim PDK ka bërë shkelje të Nenit 4.1 pikës b të Rregullës Zgjedhore të KQZ-së 11/2013 dhe Nenit 3.4 të rregullës zgjedhore 13/2013 ku me këto dispozita ndalohet vendosja e posterëve brenda ose jashtë ndërtesave publike. Në cilësi të provës parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur 2 (dy) fotografi.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4, paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, dhe nenit 120 paragrafi 1 pika a) të LZP-së, PZAP-i me datë 05.06.2014 e informoi subjektin politik PDK, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet në Kërkesë Përgjigje dhe Urdhër për të Ndërmarr Masat Përmirësuese lidhur me ankesën deri më datë 06.06.2014, në ora 10:00. Sipas afatit të caktuar PZAP-i pranoi përgjigjen në ankesë nga PDK me të cilën theksohet se posterët në fjalë nuk janë vendosur nga personat e autorizuar, por janë vendosur nga persona të pa identifikuar me qëllim të prishjes së imazhit të PDK-së, aktivistët e PDK-së kanë hequr posterët në fjalë dhe janë marrë masa përmirësuese konform nenit 120 të LZP-së. PDK përgjigjes në ankesë ika bashkangjitur edhe foto ku shihet se janë hequr posterët e vendosur.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi shkresat e lëndës gjeti se:

### **Ankesa është e bazuar**

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës se PDK ka vendosur poster në ndërtes publike në Prizren, janë të qëndrueshme ngase kjo vërtetohet nga fotografit të cilat gjendet në shkresat e lëndës.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rënduese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rënduese mori se subjekti i njëjtë politik ka marr pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se konsiderohet se është e njoftuar me procesin zgjedhor. Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i mori se PDK, pas marrjes së Kërkesës Përgjigje dhe Urdhër për të Ndërmarr Masa Përmirësuese nga PZAP-i, ka ndërmarr veprime të dukshme për evitimin e shkeljes duke i larguar posterët nga vendi ku pretendohet se ka ndodhur shkelja e supozuar.

PZAP-i duke marr parasysh të gjitha arsyet e lartcekura konstatoi se PDK ka rënë në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 1 pika b) të Rregullës Zgjedhore Nr.11/2013 dhe nenin 33 pika b) të LZP-së, i cili parashihet se *"Është e ndaluar të vendosen posterat apo pllakatat në apo mbi rrugët publike gjatë fushatës zgjedhore"*, andaj në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 pika c), si dhe nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 149/2014 më datën 06.06.2014.

Kryesuesi i Panelit  
Xhevdet Abazi



**Këshillë Juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*